



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Divizioni për Komunikim me Publikun – Divizia za Javno Komuniciranje
Division of Public Communication

Njoftim për fermerë

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural njofton fermerët se është bërë plotësim ndryshimi i masës së veçantë për zonat më pak të zhvilluara “Ngritja e aftësisë konkurruese në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë përmes përfshirjes së komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës së Veriut”.

Ndryshimet e bëra janë:

1. Pika 10 në thirrjen për aplikim, ku thuhet se përfituesit e projekteve investuese duhet të dorëzojnë projektin sipas formatit të kërkuar nga MBPZHR-ja si pjesë e aplikacionit, është ndryshuar dhe tani formulari i aplikimit merret në Zyrën Regionale të Mitrovicës Veriore ose Jugore, ose shkarkohet në uebfaqen e MBPZHR-së dhe AZHB-së.
2. Pika 11 në thirrjen për aplikim, ku thuhet se shkalla e mbështetjes publike është 90 % të vlerës së investimit, është ndryshuar dhe tani shkalla e mbështetjes publike është 80% e vlerës së investimit.

Për informacione më të detajuara, të gjithë të interesuarit të referohen në Udhëzimin Administrativ të publikuar në uebfaqen e ministrisë, www.mbpzhr-ks.net.
